

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 646 Prot.

Tiranë, më 10.052017

VENDIM Nr. 85, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim projekti për "*Godinë banimi dhe shërbimesh 2 kat mbi tokë dhe 2 kat nëntokë*" *Lagjia Nr. 1, rruga "Anastas Durrësaku"*, në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit, paraqitur nga Z. Bledar Shuaipi,

VENDOSI:

1. Investitori duhet të kontraktojë një subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të paraqesë pranë Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA) të radhës, konceptin e sondazheve arkeologjike për sheshin ku do zhvillohet projekti "*Godinë banimi dhe shërbimesh 2 kat mbi tokë dhe 2 kat nëntokë*" *Lagjia Nr. 1, rruga "Anastas Durrësaku"*, në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit, paraqitur nga Z. Bledar Shuaipi.
2. Procedura e kryerjes së sondazheve arkeologjike do të vijojë sipas përcaktimeve të vendimit të KKA të radhës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO